




Pranuar / Dorezuar Puniljena / Prodato Received / Delivered	03 - 02	2022	2	viti god year
Organ / Njesia Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSTOK	522/2022		113	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.1223/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1223/2021 të datës 24.12.2021 të parashtruar nga ankuesi e parashtruar përmes adresës elektronike: kundër Vendimit Nr. 01/70 të datës 26.11.2021 organit të punësimit Komunës së Junikut, në çështjen juridike “Pezullim parandalues”, duke vepruar në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës , në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 03.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET ankesa si e bazuar me numër A.Nr.1223/2021 e datës 24.12.2021 e parashtruar nga ankuesi

II. SHFUQIZOHET Vendimit Nr. 01/70 të datës 26.11.2021 i Kryetarit të Komunës së Junikut.

III. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Junikut për zbatimin e këtij vendimi, në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, që ankuesin ta sistemojë në një pozitë të lirë të punës që është ekuivalente, me pozitën e mëparshme të ankuesit në pajtim me përgatitjen profesionale të tij, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e tij e punë

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas shkresave të lëndës i punësuar në Komunën e Junikut në vendin e punës “Shef i Zyrës së Prokurimit” me datë 08.01.2014, është emëruar në pozitë të funksionarit publik ”Drejtor për Urbanizëm dhe Mjedis”, ndërsa Kryetari i Komunës së Junikut duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, me datë 14.04.2014, ka nxjerrë Vendimin Nr.01/38 , për Pezullim të Dakorduar të vendit të punës sipas Ligjit 03/L149 për Shërbimin Civil të Kosovës. Ankuesi pas përfundimit të mandatit të parë në pozitën e lartëpërmendur të funksionarit publikë me datë 05.01.2018 riemrohet në po të njejtën pozitë duke mbetë në fuqi vendimi për pezullim të dakorduar i datës 14.04.2014 nr.01/38.

Pas përfundimit të mandatit të ankuesit në pozitë të funksionarit publikë, me datë 26.11.2021 Kryetari i Komunës së Junikut ka nxjerrë Vendimin Nr.01/70, më të cilin ankuesin e kthen në pozitë "Zyrtar të lartë për Gjeodezi", me arsyetimin se pozita e më parëshme "Shef i Zyrës së Prokurimit", është plotësuar për shkak të aktiviteteve të punës, dhe do të shikohet mundësia në të ardhmen për baraspeshën e pozitës dhe koeficientit të pagës.

Ankuesi kundër Vendimit Nr.01/70 të datës 26.11.2021 të Kryetarit të Komunës, me datës 24.12.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, përmes adresës elektronike: e cila ankesë është regjistruar në KPMSHCK me nr. protokollit 6340/21, me pretendime ankimore kundër caktimit në pozitën e punës "Zyrtar i Lartë për Gjeodezisë" duke pretenduar që është i dmëtuar në pagë, sepse në pozitën e më parëshme koeficientin e pagës e kishte 9.5, ndërsa tani në këtë pozitë koeficientin e pagës e ka 8, gjithashtu ankuesi pretendon se Kryetari i Komunës së Junikut nuk ka bërë asnjë përpjekje që ta caktoj në një pozitë ekujvalente.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datën 31.12.2021, ka dërguar në Komunën e Junikut kërkesë për përgjigje lidhur me ankesën e ankuesit autoriteti punëdhënës, me datë 18.01.2022 ka dërguar në Këshilli, përgjigje lidhur me ankesën e lartëshenuara me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesa e ankuesit me adresë elektronike: me datë 24.12.2021 nr. protokollit 6340/21, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Vendimi Nr.01/70 i datës 26.11.2021; Vendimi Nr.01/38 i datës 14.04.2014; Përgjigje ne ankesë e datës 18.01.2022; Kontratë e punës e datës 06.05.2010; Kontratë e punës e datës 06.08.2010; Vendimit Nr.01/32 i datës 01.06.2011; Lista e pagës nga 01.04.2013 deri me datë 30.04.2013; Akte emërim i datës 04.01.2012; Përshkrimi i detyrave të punës; Kërkesë e datës 03.04.2013; Aprovim i titullit të punës dhe koeficientit i datë 03.05.2013; Ndryshim plotësimi të Akte emërimit të datës 07.05.2012; Lista e pagës nga 01.05.2013 deri me datë 30.05.2013; Vendimi Nr.01/03 i datës 08.01.2014; Vendimi Nr.01/08 i datës 05.01.2018.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e bazuar sepse,

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, i ka shqyrtuar pretendimet ankimor të ankuesit i cili pretendon se Vendimi Nr.01/70, i datës 26.11.2021 i Kryetarit të Komunës, nuk është nxjerrë sipas dispozitave ligjore në fuqi, sepse në momentin e nxjerrjes së vendimit për pezullimin e dakorduar ankuesi pretendon se ka pasur koeficientin 9.5 dhe ka qenë "Shef i Zyrës së Prokurimit", ndërsa është kthyer në vendin e punës "Zyrtar i Lartë për Gjeodezi", me koeficientin 8.

Kolegji, Konstaton se pretendimet e ankuesit janë në pajtim me dispozitat ligjore që kanë qenë në fuqi në kohën e pezullimit të dakorduar, sepse Kryetari i Komunës ka qenë i obliguar që ankuesin ta kthej në të njejtën pozitë ose në një pozitë ekujvalente ashtu sic e ka përcaktuar Ligji 03/L149 për Shërbimin Civil të Koosvës gjegjësisht:

Neni 89

Pezullimi i dakorduar i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil

1. Për qëllime të këtij ligji, rastet në vijim konsiderohen pezullim i dakorduar nga shërbimi civil: 1.1. pushimi pa pagesë; 1.2. transferimi i përkohshëm në detyra të tjera brenda ose jashtë Kosovës; 1.3. marrjes së detyrës së funksionarit publik; 1.4. kryerja e obligimeve ushtarake. 2. Pas mbarimit të kushtit të pezullimit të dakorduar, nëpunësi civil ruan të drejtën e kthimit në pozitën e mëparshme ose në një pozitë ekuivalente.



Kolegji, duke u bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se pozita e “Shef i Zyrës së Prokurimit” në Komunën e Junikut është e plotësuar, por në shkresat e lëndës nuk ekziston asnjë dëshmi që Kryetari i Komunës së Junikut të ketë bërë përpjekje që ankuesin ta caktoj në ndonjë pozitë ekuivalente me qëllim që ankuesit ti ruhet koeficienti i pagës, ashtu si e përcakton dispozita e lartëshenuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, nisur nga ajo që është thënë më lartë në këtë vendim, konstaton se Kryetari i Komunës së Junikut të merr për bazë konstatimet e këtij vendimi, që ankuesin ta sistemojë në një pozitë të lirë të punës që është ekuivalente, me pozitën e mëparshme të ankuesit në pajtim me përgatitjen profesionale, siç është e paraparë në nenin 89 paragrafi 2 i Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe 10 paragrafi 3 të Rregullores Nr.01/2011 për Ndërprerjen, Pezullimin dhe Përfundimin e Marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Kryetari i Komunës së Junikut me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.01/70 të datës 26.11.2021, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 89 paragrafi 2 i Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 paragrafi 3 të Rregullores Nr.01/2011 për Ndërprerjen, Pezullimin dhe Përfundimin e Marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, nenin 13 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, si dhe arsyetimi i tij është në kundërshtim me nenin 48 paragrafin 1 nën paragrafi 1.2, dhe paragrafin 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.1223/2021

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Junikut,
- Menaxherit të Personalit në Komunë të Junikut, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

